



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

REZULTATET KRYESORE

VLERËSIM I PËRFITUESIT
PUNËT NË KOMUNITET IV

PËRMBAJTJE

Hyrje

Detaje metodologjike të studimit

Lista e nënprojekteve

Një klimë motivuese për bizneset

Intensifikim i veprimeve të bizneseve për të zgjeruar aktivitetin

Potencial dhe dinamikë në punësim

Dyfishim i numrit të turistëve

Të ardhura nga vizitorët

Aksesueshmëria si arsye motivuese për të vizituar një zonë turistike

Përmirësim i dukshëm lidhur me kushtet e jetesës

Paqëndrueshmëria ekonomike si faktori kryesor pengues i biznesit

Vlerësim për cilësinë e punëve të kryera

Shënime për autorësinë





HYRJE

Qëllimi i këtij materiali është të informojë aktorët e interesuar dhe publikun e gjerë, lidhur me gjetjet e studimit mbi përfitimet socio-ekonomike në komunitet nga projekti “Punët në Komunitet IV”. Gjithashtu, këto gjetje mund të përdoren për të orientuar projekte të ngjashme në të ardhmen dhe të nxisë diskutimin lidhur me zhvillimin e zonave urbane dhe rurale.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, me synimin për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik në komunitete, FSHZH ka realizuar 21 nënprojekte të infrastrukturës, që përfshijnë ndërhyrje në infrastrukturë rrugore, rikualifikim urban, sistem kanalizimesh dhe furnizim me ujë të pijshëm, ndërhyrje thelbësore për rivitalizimin e zonave dhe fshatrave turistike, ndërhyrje mjedisore, trotuare, ndriçim, gjelbërim, qendra për zhvillimin e turizmit etj. Projekti është bashkëfinancuar nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB), qeveria shqiptare dhe bashkitë përfituese, WBIF. Ndërhyrjet për këtë projekt shtrihen në harkun kohor nga 2016-2020.

36.7 mln euro

6 bashki

21 nënprojekte të veçanta

11 mijë biznese

365 mijë banorë

4 vite punime

1 mln turistë në vit

Një projekt me vlerën e 36.7 mln euro i përbërë nga 21 nënprojekte të veçanta, i cili u shtri në 4 vite prek rreth 11 mijë biznese gjithsej, një popullsi prej 365 mijë banorë të gjashtë bashkive të Shqipërisë, të cilat vizitohen nga rreth 1 milion turistë në vit.

DETAJE METODOLOGJIKE TË STUDIMIT

Për të ofruar një pamje të gjithanshme mbi ndikimin e projektit “Punët në Komunitet IV”, u krye një studim vlerësimi në muajin korrik 2020*, i cili përfshiu komponentët si më poshtë:

Një hulumtim duke përdorur burime dytësore që përfshin të dhëna zyrtare nga institucionet publike kombëtare dhe vendore për të siguruar një përmbledhje të progresit të projektit të punimeve të komunitetit në fushat e zbatimit. **Tre anketa të kryera me familjet, bizneset dhe turistët.**

Anketa e Familjeve u krye me **1,200 banorë** me intervista ballë për ballë.

Bashkia	Vlorë	Himarë (Qytet, Dhërmi, Vuno, Jalë)	Pukë	Mat (Ulëz)	Tropojë (Valbonë)	Malësi e Madhe (Tamarë)	Total
Intervista të mbledhura	749 62%	150 13%	225 19%	24 2%	22 2%	30 3%	1200 100%

Anketa e Biznesit u krye me **500 biznese** me intervista në ambientet e bizneseve

Bashkia	Vlorë	Himarë (Qytet, Dhërmi, Vuno, Jalë)	Pukë	Tropojë (Valbonë)	Malësi e Madhe (Tamarë)	Total
Intervista të mbledhura	325 65%	75 15%	73 15%	17 3%	10 2%	500 100%

Anketa e Turistëve u krye me **500 turistë** me intervista ballë për ballë në pika turistike.

Zona	Himarë, Dhërmi, Vuno	Tamarë	Valbonë	Bulevardi i Vlorës, Lungomare dhe Pylli i Sodës	Total
Intervista të mbledhura	211 42%	50 10%	120 24%	116 23%	500 100%

Dymbëdhjetë (12) grupe të fokusuar me familjet, bizneset dhe përfaqësuesit e njësive administrative.

Vendndodhja	Vlorë	Himarë	Pukë	Tamarë	Total
Familje	2 x FG	2 x FG	2 x FG	-	6 x FG
Biznese	2 x FG	1 x FG	2 x FG	1 x FG	6 x FG
Total	4 x FG	3 x FG	4 x FG	1 x FG	12 x FG

**Kjo përkon me periudhën kur në Shqipëri ishte prezente pandemia e COVID-19, e cila ka ndikuar të gjithë ekonominë e vendit dhe lëvizjen e njerëzve. Në këtë aspekt, pandemia e COVID-19 ka bërë që të ulet ndjeshëm performanca financiare e bizneseve, banorët të kenë vështirësi ekonomike dhe turistët të shtyjnë shpenzimet e tyre të luksit. Pavarësisht kësaj, u bënë përpjekjet maksimale për të arritur, së pari, grumbullimin e të dhënave brenda standardit dhe cilësisë së kërkuar dhe, së dyti, për të nxjerrë një studim gjetjet e të cilit japin një paraqitje sa më reale dhe vlerësim objektiv.*

LISTA E NËNPROJEKTEVE

Nr.	Bashkia	Emri i projektit
1	MAT	Rikonstruksioni i rrugës Ulëz, bashkia Mat
2	GJIROKASTËR	Restaurimi i fasadave dhe rikualifikimi i qendrës Gjirokastrë
3	TROPOJË	Rikonstruksion i qendrës së turizmit, Valbonë
4	MALËSIE MADHE	Rikualifikim urban dhe ndërtim i qendrës së turizmit Vermosh
5	MALËSIE MADHE	Rikualifikim urban i Tamarës dhe rikonstruksion i rrugës Vermosh - doganë, mbrojtje lumore dhe ura mbi përroin e Budaçit
6	PUKË	Rikualifikim i qendrës së Pukës, faza I
7	PUKË	Rikualifikim i qendrës së Pukës, faza II
8-9	HIMARË	Rikualifikim urban në bashkinë Himarë, faza I & II
10	HIMARË	Rigjenerim urban i zonave bregdetare në fshatrat Jalë dhe Dhërmi
11	HIMARË	Ndërtimi i qendrës së urgjencës Palasë, rehabilitimi i përroit dhe zonës së parkimit në fshatin Dhërmi
12	HIMARË	Rikualifikim urban në fshatin Dhërmi
13	HIMARË	Rikualifikim urban në fshatin Vuno
14	HIMARË	Shtrimi me asfalt i dy by-passeve në Jalë dhe Dhërmi
15	VLORË	Rikonstruksioni i rrugës së Kaninës
16	VLORË	Rik. urban në bashkinë Vlorë, faza I
17	VLORË	Rik. i unazës Vlorë faza II, si dhe ndërhyrjet në bulevard dhe Lungomare
18	VLORË	Rikonstruksioni i rrugës port -pylli i Sodës
19	VLORË	Rikonstruksioni i bulevardit "I. Qemali"
20	VLORË	Rikonstruksion i sistemit të kullimit të ujërave të shiut në zonën e lagjeve Hajro Çakërrri, 4 Heronjte, 28 nëntori, Vlorë
21	VLORË	Rehabilitimi i fasadave përgjatë bulevardit të Vlorës

GJETJE NGA STUDIMI



NJË KLIMË MOTIVUESE PËR BIZNESET

93% më shumë njësi akomoduese

41% biznese të reja

- Rritje e numrit të bizneseve në 5 vitet e fundit në bashkinë Himarë, Malësi e Madhe dhe Tropojë përkatësisht 8%, 56% dhe 52%. Sipas anketës, 41% e bizneseve të anketuara janë hapur në këtë periudhë;
- Rritje e ofertës turistike përmes rritjes prej 93% e njësisve akomoduese për të gjithë zonën e investimit krahasuar me vitin 2015;
- 12% e bizneseve të anketuara shprehen se kanë performancë financiare të mirë ose shumë të mirë.

“ Unë kam një dyqan me roba, i cili gjendet në bulevard. Ka ndryshuar çdo gjë për mua, tani gjithkush ka akses më të lehtë në dyqanin tim. Ka patur një aspekt shumë pozitiv.

Pjesëmarrëse Grua, grup diskutimi me Bizneset, Vlorë

INTENSIFIKIM I VEPRIMEVE TË BIZNESEVE PËR TË ZGJERUAR AKTIVITETIN

“ Përpara ndërtimit të “Lungomares”, Vlorë ishte thjesht një ndalesë gjatë udhëtimeve drejt jugut të Shqipërisë. Tani, turistët rezervojnë pushimet edhe në Vlorë, dhe bizneset rreth tij kanë lulëzuar, ato ofrojnë gjithçka për të cilën ka nevojë. Pjesëmarrëse Grua, grup diskutimi me qytetarët. Vlorë

- Rreth 17% e bizneseve kanë blerë pajisje shtesë të reja gjatë vitit 2019, rreth 34% e firmave kanë përmirësuar pajisjet ekzistuese gjatë 4-vjeçarit të fundit dhe 34% kanë përmirësuar ambientet e biznesit gjatë kësaj periudhe;
- Turistët e vlerësojnë cilësinë e akomodimit duke shprehur një notë mbi mesatare;
- Rreth 22% e bizneseve përdorin rrjetet sociale për qëllime biznesi. Një në pesë turistë thanë që kanë bërë prenotimin përmes booking.com ose Airbnb.



POTENCIAL DHE DINAMIKË NË PUNËSIM

67% më pak të papunë

41% sipërmarrje individuale

- Numri i të papunëve të regjistruar ka rënë me 67% në zonën e investimit në 5 vitet e fundit, sipas të dhënave zyrtare;
- Kryesisht në bizneset e Himarës u vu re se rekrutojnë edhe persona nga rajone të tjera dhe këto biznese përfshijnë rreth 69% e të punësuarve në zonat ku është investuar. Nga ana tjetër rreth 41% e bizneseve janë sipërmarrje individuale.

DYFISHIM I NUMRIT TË TURISTËVE

Të dhënat zyrtare tregojnë se ka një rritje nga 0.5 në 1 milion turistë nga viti 2015 në vitin 2019 për këto zona. Për më tepër, shumica e turistëve konsiderojnë të kthehen në zonat ku janë bërë ndërhyrjet për ta vizituar sërish dhe se rekomandojnë të afërmit e tyre për të bërë të njëjtën gjë.

“ Kam vënë re se shumë turistë ndalojnë për t'u bërë fotografi shtëpive të rindërtuara në kodër në Vuno. Unë besoj se rikonstruktimi ka shtuar bukurinë në pamje dhe ofron diçka origjinale për turistët. Pjesëmarrëse Grua, grup diskutimi me qytetarët, Himarë





TË ARDHURA NGA VIZITORËT

- Shpenzimet e turistëve shkojnë kryesisht për akomodimin dhe ushqimin. Sipas anketës së turistëve, shpenzimi mesatar për turist është rreth 5,500 lekë në ditë, ku në Dhërmi vlera shkon në 7,200 lekë;
- Rreth 8% e udhëtarëve kanë blerë produkte artizanale.

“ Investimi i bërë në Vlorë ka sjellë jetë në atë pjesë të qytetit ku nuk ndodhte asgjë. Ndikimi në turizëm do të matet verën tjetër, duke qenë se investimi është i ri. Pjesëmarrëse Grua, grup diskutimi me qytetarët, Vlorë ”

AKSESUESHMËRIA SI ARSYE MOTIVUESE PËR TË VIZITUAR NJË ZONË TURISTIKE

Tre në katër turistë shprehen se vendndodhja dhe aksesueshmëria, duke nënkuptuar sistemin dhe cilësinë e rrugëve për të arritur zonën, janë arsye kryesore që motivon turistët për të vizituar një zonë turistike.

“ Përpara këtyre investimeve, Tamara nuk ishte e aksesueshme dhe nuk kishte asgjë për të parë këtu. Tani, ne kemi mundësinë të promovojmë zonën tonë. Pjesëmarrëse Grua, grup diskutimi me bizneset, Tamarë ”

PËRMIRËSIM I DUKSHËM LIDHUR ME KUSHTET E JETESËS

25% më pak familje në nevojë

22% e familjeve me më shumë të ardhura

- 25% më pak familje në nevojë, krahasuar me 2015 në bazë të burimeve zyrtare;
- 22% e familjeve të intervistuar kanë pasur rritje të të ardhurave;
- Shumica e banesave kishin ujë në rubinet dhe shtim i konsiderueshëm i orëve me furnizim me ujë;
- Më shumë se 90% e familjeve në Pukë, Vlorë dhe Mat kishin akses në sistem të ujërave të zeza;
- Rreth 40% e familjeve shprehen se vlera e banesës së tyre ishte rritur, ndërsa 30% thonë të njëjtën gjë për qiranë e banesës.

“ Shëtitorja e Dhërmiut ka përmirësuar cilësinë e jetës për shumë banorë, neve na pëlqen shumë të bëjmë një shëtitje atje gjatë netëve të verës. Turistët e konsiderojnë atë si një atraksion dhe si një pikë lidhëse me plazhet. Pjesëmarrëse Grua, grup diskutimi me qytetarët, Himarë ”

Për ne që jemi pronarë të hoteleve, kanalizimet e ujit janë thelbësore dhe një nevojë themelore. Pa të, ne nuk do të ishim në gjendje të ofronim shërbime cilësore për klientët tanë, por çdo vit po bëhet më mirë. Pjesëmarrës Burrë, grup diskutimi me bizneset, Himarë ”

PROBLEMATIKA


PAQËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE SI FAKTORI KRYESOR PENGUES I BIZNESIT

Rreth 70% e bizneseve të anketuar shprehen se paqëndrueshmëria ekonomike është problematika më e madhe me të cilën përballet aktiviteti i tyre. Më pas vjen niveli i taksave (19%). Për çështje operacionale dhe të rritjes së biznesit problemi më i përmendur është gjetja e punonjësve me eksperiencë (24%) dhe taksat mbi pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore (8%). Shumica e bizneseve (77-80%) u shprehen se qeveria duhet të rrisë ndihmën për përmirësime infrastrukturore si dhe në të tjera çështje që lidhen me turizmin si organizimi i eventeve për të promovuar turizmin dhe pjesëmarrje në aktivitete të turizmit.



VLERËSIM PËR CILËSINË E PUNËVE TË KRYERA


Bizneset vlerësuan se krahasuar me 4/5 vite më parë janë përmirësuar: kushtet e rrugëve për në zonë (72% e bizneseve), kushtet e rrugëve brenda zonës (73%), infrastruktura e përgjithshme e zonës (57%), kushtet e ndërtesave (51%), cilësia e rrugëve për këmbësorët (56%), ndriçimi i rrugëve (51%) dhe hapësirat gjelbra (51%). Për më tepër, më shumë se gjysma e familjeve kanë deklaruar se këto elemente infrastrukturor janë përmirësuar në krahasim me 4/5 vite më parë. Gjithashtu turistët shprehën vlerësim të lartë lidhur me cilësinë e punimeve të realizuara.



“Përveç liqenit dhe bulevardit, ajo që ka ndryshuar vërtet fytyrën e Pukës janë fasadat e shtëpive, të cilat janë vizualisht të kënaqshme dhe i japin qytetit një pamje moderne. Pjesëmarrëse Grua, grup diskutimi me qytetarët, Pukë”

Më poshtë ilustron një tregues i përgjithshëm i matjes së kënaqësisë së komunitetit, bizneseve dhe turistëve, i cili nxjerr në pah se në tërësi të intervistuarit janë të kënaqur me elementët infrastrukturor, duke shënuar 75 pikë për rastin e komunitetit, 76 pikë nga bizneset dhe 72 pikë nga turistët. Kujtojmë se elementët infrastrukturor nënkuptojnë rrugët, rregullimin e fasadave dhe shesheve së bashku me shëtitorët dhe aspekte të tjera që lidhen me infrastrukturën.

Sipas të dhënave nga anketa e familjeve, më mirë rezultojnë Puka, Ulëza dhe Tamara me një vlerë të treguesit në nivelin 88 dhe 87 pikë nga 100. Ky është një rezultat shumë i mirë sipas interpretimit të këtij treguesi. Sipas bizneseve vlera më e lartë rezultojnë në rastin e Tamarës, ndjekur nga Puka dhe Vlora (87, 82, 80 pikë përkatësisht), ndërkohë Himara arrin 53 pikë.



E rëndësishme është të theksohet se, në dallim nga rezultatet e anketës së komunitetit dhe bizneseve, në rastin e turistëve nuk ka një diferencë të madhe mes zonave të vlerësuara. Në ndjekje të këtij arsyetimi, mund të përmendim se vlerësimin më të ulët e merr Pylli i Sodës me 65 pikë, por shumë pranë me Himarën dhe Valbonën. Ajo që duhet theksuar nga ky rezultat është se turistët janë të kënaqur me elementët infrastrukturorë në zonat ku është realizuar investim.

SHËNIME PËR AUTORËSINË

Ky studim është përgatitur nga IDRA Research & Consulting me mbështetjen e Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH).

IDRA Research & Consulting

IDRA Research & Consulting është një kompani lider e hulumtimeve të opinionit dhe tregut me zyrë në Tiranë (Shqipëri) dhe Prishtinë (Kosovë) që vepron në rajon e më gjerë. IDRA (www.idracompany.com), e themeluar në vitin 2006 në Tiranë, është një degë e Institutit për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi (www.idrainstitute.org) themeluar në vitin 2000) dhe 20 vite përvojë në kryerjen e studimeve dhe ofrimit të konsulencës për projekte të kompanive dhe institucioneve vendase dhe ato ndërkombëtare. Nga viti 2018 ka hapur një zyrë edhe në Vietnam.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është organizatë zhvillimore që i përgjigjet sfidave dhe partnerëve të saj në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit. E themeluar që në vitin 1993, FSHZH ka një përvojë 25 - vjeçare zhvillimin e infrastrukturës, urbanizimit, turizmit dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Për më shumë informacion, shiko www.albaniandf.org.



Studimi financohet nga Banka e Këshillit të Europës (CEB), përmes grantit SDA, në kuadër të projektit “Punët në Komunitet IV”.

